IUCN

CEC
Commission on Education and Communication

COMICS UNITING NATIONS

PATRULLA POSEIDON

AUTORËT: MARK NADEL DHE MAREN GARNE

14 JETA NË UJË

QËLLIME PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA

GALLIFREY FOUNDATION

BEAT PLASTIC POLLUTION

WORLD ENVIRONMENT DAY

UN environment

PATRULLA POSEIDON

Skenari dhe vizatimi: Mark Nadel
Ngjyra: Maren Gagne
Producenti dhe eksperti i ndotjes nga plastika: Alexis McGivern
Vendosjen e tekstit: Marco Rodriguez

Producenti ekzekutiv
Sean Southey

COMICS UNITING NATIONS
Natabara Rollosson
Shannon O'Shea
Callie King-Guffey
Graciela Leal
Jocelyn Iverson
Marco Rodriguez

NË PARTNERITET ME PROGRAMIN GLOBAL
DETAR DHE POLAR TË IUCN

UICN

www.iucn.org/theme/marine-and-polar

ME MBËSHTETJE NGA FONDACIONI "GALLIFREY"

GALLIFREY
FOUNDATION

FALËNDERIM TË VEÇANTË PËR "BYE BYE PLASTIC BAGS"

BYE BYE PLASTIC BAGS

www.byebyeplasticbags.org

"By Bay Plastic Bags" është organizatë joqeveritare ku forca kryesore lëvizëse është rinia e cila po përpiqet të rrisë vetëdijen e njerëzve në Bali për t'i thënë "JO" qeseve të plastikës. Sot është lëvizje ndërkombëtare që frymëzon dhe fuqizon të rinjtë me prejardhje të ndryshme në të gjithë botën, me theks në edukimin dhe ndryshimin e politikave mjedisore!

Fëmijë, vëmendje!!! Ky libër komik ka krijesa madhështore të detit, dhe ju jeni në zonën e ujit dhe në qendër të të gjitha ngjarjeve! Kështu që vishni syzet e notit, vishni pendët e notimit dhe menjëherë zhytuni në ujë me:

PATRULLA POSEIDON




Albatross, udhëheqësi misterioz i Patrullës Poseidon ata e njohin vetëm si Alfa.
Pra, më vjen mirë që shumica jeni këtu
Kemi një krizë emergjente në duart tona --- mmmm, krahët tona---- mmmm, pendët.
Oh, jo! A janë kthyer sardelet hapësinore nga Sirius 7?
Ku do të kthehen mor, Fjalvlera! Ti i hëngre të gjitha, a të kujtohet?
Epo, thjesht desha t'i ndihmoj ato! Ishin aq shumë të ngjeshura në atë anije kozmike të vockël ....!
Ahmm! Ta marrim punën seriozisht!
Po, shokë, dëgjoni udhëheqësin!
Vetëm edhe diçka para se të fillojmë ...
Tung Al! Më falni për vonesën!
Ahheeejjj!!! Kujdes, o kokëtul! Kokëtul i gjorë! Dhe mos më quaj Al!


Detyra juaj e re është sa e rëndësishme po aq e rrezikshme, kështu që dëgjoni me kujdes!
Go-Gon, teleporto të ftuarit tanë!
Ju sollëm Isabelën dhe Melatin nga Ishulli Bali për të na njoftuar me problemin që „mbush" oqeanet!
Përshëndetje Patrulla „Poseidon"! Ne do t'ju tregojmë të gjithëve në lidhje me misionin tonë të quajtur „Lamtumirë Qeset e plastikës", përpara se të filloni tuajën.
Ne rrisim vetëdijen për rrezikun e ndërlikuar të qeseve plastike të thjeshta që i shkaktojnë botës detare dhe shëndetit të njeriut.
Ugh! Pasi pashë qindra qese që notonin përreth, mendova se ishin kandil deti! Por kandilat e detit janë shumë të shijshëm!
Shumë njerëz dhe biznese hedhin qese të tilla dhe plastika të tjera në mënyrë të gabuar.
Mbeturinat plastike ndotin lumenjtë dhe oqeanet, kërcënojnë shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, si dhe botën detare.
Plastikat dhe mbeturinat e tjera të patrajtuara, siç janë pjesët e vjetra të kompjuterëve, janë mbledhur në oqeane. Disa prej qeseve plastike shpërthejnë në miliarda copa të imëta që pluskojnë dhe quhen „mjegull deti".
Madje edhe plastika e imët paraqet problem! Një javë më parë, vëllai im Maksi u ngatërrua në një rrjetë të vogël plastike dhe na u desh shumë kohë që ta çironim.
Njerëzit duhet të ndalojnë hedhjen e mbeturinave plastike dhe mbeturinave të tjera që nuk mund të shpërbëhen.
Fëmijët mund t'ua tregojnë këtë problem prindërve të tyre, në mënyrë që të krijojnë më pak mbeturina.
Ka vende ku mund ta çojnë plastikën për ta përpunuar ose ricikluar.
Me pak njohuri, familjet do të jenë në gjendje t'i shpëtojnë kafshët e detit dhe të parandalojnë planetin tonë të bëhet një deponi e madhe!


Faleminderit vajza! Ju keni bërë shumë për ta parandaluar ndotjen nga plastika.
Po! Dhe superfuqitë e tua të vetme janë idetë, guximi dhe vendosmëria.
Ne duam që ju të jeni anëtare të Patrullës sonë „Poseidon"!
Kurdo që të keni nevojë për ndihmën tuaj, ne do të jemi menjëherë këtu!
Faleminderit, djema dhe paçi fat në misionin tuaj!
Kur jemi te kjo ... dje dy ngjala elektrike po luanin „zzzgjebe", kur befas ...
ZZZZAPP!
Nuk mund të më kapësh, Tesa!
Hej, Edi, mendoj se kemi shkuar shumë thellë! Kam pak frikë!
ZZZAPP!!
Uuaaaauu!
Offf! Çfarë ishte ajo?
Mendova se ishe ti?
AJO ISHA- UNË!!!
Shkëndite e juaja të vockla e zgjuan GARBABUMIN! Dhe tani bota do të dridhet nga frika!


Shkarkimet tuaja elektrike zgjuan miliona pjesë kompjuterike nga mbeturinat. Me secilën sekondë që kalon, fitoj më shumë njohuri!
Tani në trupin tim absorbohet plastikë me tonelata!
Për dekada të tëra, njerëzit dhe kompanitë e kanë trajtuar oqeanin si një deponi të madhe. Çdo ditë këta teveqelët përdorën materiale siç është plastika që nuk shpërbëhet!
Gati gjithçka që hedhin, përfundon në oqean! Por tani jam zgjuar dhe do t'ia shkruaj fatin të gjithëve! Ata mendojnë se i hodhën mbeturinat dhe mbaruan punë, ashtu? Dhe tani do të dal në brigje dhe do t'i shkatërroj qytetet e tyre!
Plastika nuk shpërbëhet në ujë të kripur! Vetëm mblidhet! Nëse njerëzit janë mjaft inteligjentë për të prodhuar materiale të tilla, pse nuk janë aq të zgjuar të gjejnë mënyrë se si të shpëtojnë prej tyre?
Tani njerëzit e gjorë do të përballen fjalë për fjalë se çfarë do të thotë "larg syve, larg mendjes!!!" Do t'ju futet frika në palcë nga Garbabum!!!


Dilni të gjithë nga vorbula ujore, shpejt!
Në mbrojtje, përbindësh!
Prit, Aram --- mmmm ---- Dua të them, Aramis!
Shpejtë! Të gjithë qëndroni prapa meje! Kam një magji të përsosur për këtë!
Ehm! Në emër të barishteve ujorë të detit Sargasso, ju urdhëroj të shqetësohesh!
Të shqetësohesh???
Uhh ... mendova, të qetësohesh! Të qetësohesh!!!
Dhe jam i paduruar. Kam shumë qytete për të shkatërruar dhe po bëhet vonë!
Hmmm, çun i madh, mos shiko tan!! ...
Për pak! Por më lini të merrem me këtë lëmsh të madh të modemeve dhe shisheve të qumështit!
Së shpejti do të shohësh se unë nuk jam lëmsh, o mikrob! Jam unë kriza!


PLES-BAAAM!
... JA NJË GODITJE! POR ... DHE UNË ... U... GODITA ...
OHHHH! KUSH E DI SA FORT U GODITA! ENDE PO NUMËROJ YJET!
NE DONIM TË SIGUROHEMI NËSE ISHE MIRË, BALENA!
UH! MË SHPËTOI BOJA!
A JE MIRË
MOS MË GËNJE!
ASNJËHERË MË MIRË!
E PRA TË SHOHIM SI ËSHTË AI TJETRI.


A me dëgjon? A je mirë?
Çfarë është kjo? Ndonjë truk? Dil nga koka ime menjëherë!
Do të dal, premtoj, por të lutem fillimisht të qetësohesh. Mendo logjikisht. Përdor informacionet te të cilat ke arritur. Unë kam vetëm një pyetje t'ju bëj. Përgjigju dhe do të të lë!
Mirë, moj bukël ujore! Më pyesni çfarë të do të dish dhe pastaj mu hiq qafësh!
Për shkak se ti ke njohuri për të gjithë globin, me siguri e di se Toka ka nevojë për ndihmën tënde. Pra, si mund t'i japim fund krizës së ndotjes nga plasitka e oqeaneve tona?
Po kjo është e lehtë, mund të llogaritet! Duhet vetëm të ... po ... ehm ... jo... unë nuk e di.
Kur njerëzit shpikën plastikën, ata nuk mund ta imagjinonin që do të bëhej problem kaq i madh. Sot, ka shumë që duan të jenë pjesë e zgjidhjes - veçanërisht fëmijët!!
Në vend që të shkatërrosh qytetet, vizito shkolla dhe trego fëmijëve se si ndodhi që u krijove! Duke vepruar kështu ata do të ndikojnë në miqtë dhe familjet e tyre të ndalojnë përdorimin e plastikës dhe kjo do të bëjë ndryshim të madh!
Hmmm ... mirë thua ...
Jam i sigurt se mikeshat tona Melati dhe Isabela do t'ju shpjegojnë se sa ndikim të madh ka misioni i tyre për të ndaluar ndotjen nga plastika!
Mos ki frikë, vogëlush! Unë do të të mbroj me bririn tim të fuqishëm!
Por unë nuk kërkova ndihmë ...
Në emër të shpirtrave të mëdhenj dhe të lartësuar të shtatë deteve - TI NUK DO TË NDALOSH!!!
U BËPALAR Ë!
Duhet të thuash „kalosh", e jo „ndalosh". „Ti nuk do të kalosh!"
Ooof! Përsëri?! Dhe tani mu zbraz kërmilli i detit.
Është në rregull. Rreziku kaloj.
Vërtet?


Duhet ta zgjedh këtë! Pse nuk është duke bërë llogari????
Të gjithë duhet të pyesim veten: çfarë mund të bëj unë?
Jam duke përpunuar informata- pse nuk mund të marr të dhëna të mjaftueshme për të ... Prisni! Ja ku është!
Hej! A nuk duhet ta ndalojmë?
Jo. Ai nuk është më problem ...
... dhe ai mund të jetë një pjesë më e madhe e zgjidhjes.
Unë do të absorboj sa më shumë plastikë që mundem, dhe pastaj t'u tregoj njerëzve që duhet të ndihmojnë gjithashtu.
Më vonë në „Atolin Askund" ...
Bëtë punë të shkëlqyer! Tani detyra juaj e radhës do të jetë ... Hej! Kini vëmendjen pak?!
Ne mund ta shfrytëzojmë këtë ditë për të luajtur.
E di, val-deti! Detyra juaj tjetër e Patrullës „Poseidon", është të argëtoheni!
Dhe kjo është një urdhër!
Dhe mos harroni, fëmijë ... Jo më qese klasike ... uff... desha të them... qese plastike!
Fund

QËLLIMET ZHVILLIMORE TË QËNDRUESHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA

14 JETA NË UJË

QËLLIMI 14: BOTA DETARE

Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve në dete dhe oqeane.

Për të arritur Qëllimin nr.14,
Shtetet kanë rënë dakord si vijon:

- Ulja e ndotjes në dete dhe oqeane deri në vitin 2025, pasi pjesa më e madhe e ndotjes është shkaktuar nga aktivitetet njerëzore në tokë
- Miratimin e ligjeve që ndalojnë peshkimin e paligjshëm, peshkimin e tepërt dhe praktikat e tjera shkatërruese të peshkimit
- Sigurimi i mbështetjes financiare për vendet më të varfra dhe ishujt e vegjël për mbrojtjen dhe menaxhimin më të mirë të burimeve ujore, duke menduar për të ardhmen
- Minimizimi dhe adresimi i efekteve të acidifikimit të oqeaneve.
- Deri në vitin 2030, rritja e përfitimeve ekonomike për shtetet e vogla ishullore dhe vendet më pak të zhvilluara përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore. Kjo do të nënkuptonte një menaxhim të qëndrueshëm të peshkimit, akuakulturës dhe turizmit.

Për më shumë informacion:

COMICS UNITING NATIONS

comicsunitingnations.org

GALLIFREY FOUNDATION

www.gallifrey.foundation

unicef pci media tell a story, change the world. PUBLIC FOUNDATION IUCN CEC Commission on Education and Communication WORLD'S LARGEST LESSON

MOS INJORO REAGO

Për ndryshime më të vogla klimatike

Botues: Instituti për Studime të Komunikimit
Redaktim i tekstit në gjuhën shqipe: Frosina Pandurska-Dramikjanin
Përktheu: Vjosa Taipi
Dizajni grafik: Dejan Joveski
Viti: 2019
E botuar për herë të parë nga: Comics Uniting Nations

Институт за комуникациски студии

MOS INJORO REAGO
për ambient më të mirë jetësor

Ky libër është përpiluar në kuadër të fushatës me interes publik për mjedis më të mire jetësor „Mos injoro! Reago!" i Institutit për Studime të Komunikimit

www.iks.edu.mk www.reagiraj.mk

British Embassy Skopje

Funded by UK Government

Ky libër është përpiluar në kuadër të projektit "Mbështetje për qeverisje të mirë nëpërmjet pjesëmarrjes civile për transparencë më të madhe dhe llogaridhënie të institucioneve në Maqedoni" financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës së Britanisë, Shkup. Mendimet dhe qëndrimet në këtë përmbajtje nuk i reflektojnë çdo herë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.